



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:007581

Datë: 13.07.2023

Numri i dokumentit: 04483090

C.nr.139/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses J. S. nga Prishtina të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Av. L. K. G. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) të cilën e përfaqëson A. K., me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë dhe ushqimit gjatë punës (shujtave), jashtë seancës gjyqësore me datë 25.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses J. S. nga Prishtina, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), që paditëses t'ia paguaj shumën si në vijim, në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e punës mbi 13 vite, -50% të pagës bazë, shumën prej 202.50 €, dhe në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave ditore në punë, për 1069 ditë pune, shumën prej 2.138.00€, me kamatë ligjore në shkallë prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 18.01.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën prej 229.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësueses së saj, me datë 18.01.2021, ka paraqitur padi dhe kërkesëpadi, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës jubilarë dhe shpenzimet e ushqimit në punë (shujta).

Në padi paditësja ka theksuar se duke marrë parasysh se nuk i janë paguar-kompenzuar pagat jubilarë dhe shpenzimet e ushqimit në punë, dhe pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017, paditësja përmes të autorizuarës së saj i është drejtuar organit kompetent, gjegjësisht Komunës së Prishtinës-Drejtorisë së Arsimit, si punëdhënësi i fundit, me kërkesë për kompenzimin e pagave jubilarë dhe shpenzimit të ushqimit në punë.

Paditësja ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e saj, duke e detyruar të paditurën t'ia kompensojnë paditëses shpërblimin e pagës jubilarë dhe kompensimin e ushqimit-shujtave dhe atë: shumën prej 202.50€ për shpërblim jubilar për mbi 13 vite të përvojës së punës -50% të pagës bazë, dhe në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave, shumën prej 2,138.00€ për 1069 ditë pune, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në vit, nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se e njëjta nuk ka ofruar prova se ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se ti drejtohet gjykatës me padi, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Punës, ku në nenin 78 par.1 përcaktohet se i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës mund të paraqes kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit, për realizimin e të drejtave të shkelura. Më tej e paditura thekson se kompenzime të tilla nuk janë paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212 dhe rrjedhimisht e paditura Komuna e Prishtinës gjatë pregaditjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linjë të veçantë buxhetore, për këto lloje të kompensimit. E njëjta i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazë.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditëses është e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike,

dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se:

Në mes të palëve ndërgjyqëse rezulton se nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse e Edukatës Muzikore në SHFMU “Ismail Qemali” në Prishtinë, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës edhe nga kontrata e punës e datës 08.02.2012, vërtetimi i përvojës së punës i datës 09.12.2020 dhe vërtetimi mbi ditët e pranisë në punë i datës 08.12.2020 dhe i datës 13.09.2022.

Nga vërtetimet e punësimit të cekura më lartë, të cilave gjykata ju fali besimin me rastin e vendosjes sa i përketë lartësisë së kërkesëpadiës së paditëses, sepse nga e njejta konstatoi se paditësja tek e paditura realizon pagë mujore në shumë prej 405.00€.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar me datë 18.04.2017, ku sipas kësaj kontrate, bazuar në nenin 35 par.7, par.8 dhe par.9, citohet: 7. Të punësuarve u sigurohet kompenzim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2(dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.

8. Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë:

8.1. për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë

8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë

8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të 100% të një page bazë

8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë

8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të nxjerra nga paditësja, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, sepse paditësja e gëzon të drejtën që në vitet jubilarë të punësimit të përfitojë shpërblim jubilar, i cili do të jetë ekuivalentë me pagën mujore dhe në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave ditore në punë, me nga 2 euro për një ditë pune.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të i'a kompensoi paditëses, për vitet jubilarë të punësimit, shpërblimin jubilar dhe në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave ditore në punë, për çdo ditë të pranisë në punë. Andaj paditësja e ka cilësinë e kreditorës ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses të ja kompensoi shumat e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 18.01.2021, dita e paraqitjes së kërkesëpadiës në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nuk janë paraparë me Ligjin e Punës nr.03/L-212 dhe si të tilla nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore. Për më tepër derisa këto obligime janë qartë të specifikuara në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditëses, duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë

buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditësja.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzime e procedurës, gjykata e bazoi në nenet 449 dhe 452 të LPK-së, sipas të cilave paditëses i pranohen shpenzimet në shumë prej 229.00 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë, shumën prej 208.00 € dhe në emër të taksës për padi shumën prej 21.00 €.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.139/21 datë 25.05.2023

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.